UDHËZIM
Nr. 14, datë 13.3.2025

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 3.5.2024, "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT, TË PEZULLIMIT DHE TË LARGIMIT TË MËSUESIT NGA NJË VEND PUNE, SI DHE ADMINISTRIMIT TË PORTALIT 'MËSUES PËR SHQIPËRINË"', I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 8, datë 3.5.2024, "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit 'Mësues për Shqipërinë"', i ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë:

a) Pas pikës 2, të kreut II, shtohet pika 2/1, me përmbajtje, si më poshtë:

"2/1. Përjashtimisht, në përbërje të Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve (KVD), të ngritur sipas pikës 2 të këtij kreu, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve të cilët në aplikimin e tyre kanë përzgjedhur për punësim ZVAP Shkodër, Divjakë, Berat dhe Kolonjë, caktohet edhe nga 1 (një) përfaqësues nga bashkitë e përfshira në projektin pilot në ushtrimin e përgjegjësive në fushën e arsimit parauniversitar.

Kjo përbërje e KVD-së zbatohet sipas kohëzgjatjes së marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet MAS-it dhe bashkisë përkatëse.".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, Bashkia Shkodër, Bashkia Berat, Bashkia Divjakë, Bashkia Kolonjë dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar në territorin e këtyre bashkive.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Orjana Osmani